

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 24, datë 21.11.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 20, DATË 20.9.2019, “PËR SKEMËN DHE ZBATIMIN E MODELIT TË FINANCIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 3, të nenit 110, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, të ndryshuar, ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Pika 5, e kreut III, të udhëzimit të përbashkët nr. 20, datë 20.9.2019, të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”, ndryshon si më poshtë:

“5. Miratimi i shpërndarjes së fondeve të kësaj kategorie në formën “grantit për mësimdhënie për institucionet publike të arsimit të lartë”, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 604, bëhet me vendim të Bordit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), me përfitues institucionet publike të arsimit të lartë, bazuar në modelin e financimit të miratuar sipas legjislacionit në fuqi.

Një kopje e vendimit të Bordit Drejtues përcillet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t’u regjistruar në sistemin financiar AMFIS.”

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ogerta Manastirliu

MINISTËR I FINANCIVE DHE EKONOMISË

Ervin Mete